



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

KABINETI I KRYETARIT / URED PREDSEDNIKA / CABINET OF THE PRESIDENT

Prishtinë, më 28 maj 2019
Nr. ref.: KK 141/19

Z. Aleksandër Lumezi

Kryeprokuror i Shtetit
Prishtinë, Republika e Kosovës

Lënda: Njoftim për moszbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KIo8/09

I nderuari Kryeprokuror i Shtetit, z. Lumezi,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, bazuar në kompetencat e përcaktuara me Kushtetutë, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin dhe për vlerësimin e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Sipas nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore dhe nga palët e autorizuara. Në kuadër të këtij neni, Kushtetuta, ndër të tjera, ka përcaktuar që edhe individët (personat fizikë dhe juridikë) kanë të drejtë të paraqesin ankesa kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese dhe të kontestojnë kushtetutshmërinë e vendimeve të autoriteteve publike, përfshirë veprimet apo mosveprimet e tyre, përkitazi me shkeljen e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë, me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Duke vepruar sipas kërkesës individuale nr. KIo8/09, të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese nga Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së çelikut – IMK Ferizaj, Gjykata Kushtetuese, më 17 dhjetor 2010, ka nxjerrë Aktgjykim në bazë të të cilit ka gjetur shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 (E drejta për Gjykim të Drejtë) dhe 13 (E drejta për Zgjidhje Efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me atë rast, Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se një vendim i Gjykatës Komunale në Ferizaj ishte bërë final dhe i detyrueshëm dhe, si i tillë, duhej të ekzekutohej nga autoritetet kompetente, në veçanti nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhëse ligjore e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. (Shih pjesën operative të Aktgjykimit KIo8/09).

Më 12 maj 2011, pas kërkesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Gjykata Kushtetuese kishte lëshuar një Sqarim për Aktgjykimin KIO8/09 (Shih bashkëngjitur Sqarimin e Gjykatës Kushtetuese). As pas këtij Sqarimi, Aktgjykimi në fjalë nuk ishte ekzekutuar. Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese, më 18 tetor 2012, kishte nxjerrë Vendim për Mospërmbardim të Aktgjykimit KIO8/09, duke theksuar se arsye për nxjerrjen e këtij vendimi është fakti që Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk kanë përmbarduar Aktgjykimin KIO8/09. As pas masave të lartpërmendura, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nuk është zbatuar dhe, sipas informatave që Gjykata ka pranuar nga parashtruesit e kërkesës dhe nga palët e tjera të përfshira në rast, ky Aktgjykim akoma vazhdon të ngelet i paekzekutuar (Shih bashkëngjitur Vendimin për Mospërmbardim).

Siç jeni në dijeni, bazuar në nenin 116 [Efekti juridik i vendimeve] të Kushtetutës, vendimet e shpallura nga Gjykata Kushtetuese "*[Janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.]*" Mosekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përbën shkelje kushtetuese dhe është në kundërshtim me parimet bazë të sundimit të ligjit në një shtet ligjor dhe demokratik.

Në linjë me këtë dispozitë kushtetuese, rregulli 66 (Zbatimi i vendimeve) i Rregullores së punës përcakton që të gjitha organet kushtetuese, përfshirë gjykatat dhe autoritetet e tjera, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës – brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. Pika (7) e këtij rregulli përcakton që "*Prokurori i Shtetit informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.*"

Andaj, me qëllim të jetësimit të obligimit të Gjykatës Kushtetuese që të përcjellë zbatimin e vendimeve të saj dhe të ndërmarrë masat e nevojshme të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës, ju njoftojmë që Aktgjykimi KIO8/09 nuk është zbatuar. Si rrjedhojë, ky rast akoma nuk mund të konsiderohet plotësisht i mbyllur dhe i përfunduar duke qenë se vendimi i Gjykatës ngelet i pazbatuar nga organet përgjegjëse të identifikuar në pjesën operative të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KIO8/09.

Ne ju ftojme që, në bazë të kompetencave tuaja, të ndërmerrni të gjitha veprimet e që ju i konsideroni të nevojshme dhe të duhura për të ndihmuar në zbatimin përfundimtar të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit mbetet e përkushtuar në realizimin e plotë të funksionit të saj të gardianit të Kushtetutës dhe të garantuesit të të drejtave të njeriut. Për realizimin e këtyre qëllimeve, Gjykata Kushtetuese mirëpret bashkëpunimin me ju, gjithmonë në interes të respektimit të kushtetutshmërisë dhe të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Bashkëngjitur: Vendim për Mospërmbardim të Aktgjykimit KIO8/09.

Me respekt,

Arta Rama-Hajrizi
Kryetare

